

UNIVERSITETI I GJAKOVËS
FAKULTETI I MJEKËSISË
PROGRAMI I INFERMIERISË



PUNIM DIPLOME

TEMA: Njohuri e popullatës për shëndetin dhe faktorët që ndikojnë në shëndet

Kandidatja:
Ardijana Gjini

Mentori:
Prof. Ass. Haxhi Kamberi

Gjakovë 2016

Abstrakti

Shëndeti është niveli i efikasitetit funksional apo metabolik të qenies së gjallë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), shëndeti është "gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mentale dhe sociale dhe jo vetëm mungesa e sëmundjes ose paaftësisë".

Njohuritë e popullatës për shëndetin dhe faktorët e rrezikut janë edhe indikator i gjendjes shëndetësore të popullatës. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte njohja me nivelin e njohurive të popullatës lidhur me shëndetin dhe disa faktorë të rrezikut. Në studim morën pjesë 200 individë nga komuna e Gjakovës. Qytetarët u zgjodhën rastësisht për këtë studim. Moshë mesatare e pjesëmarrësve në studim ishte 36 vjeçare. Sipas vendbanimit në hulumtim janë përfshirë 82 persona nga vendbanimet urbane (41 %), dhe 118 persona nga vendbanimet rurale (59 %). Sipas gjinisë në hulumtim janë përfshirë 200 persona nga të cilët 92 kanë qenë meshkuj (46 %) dhe 108 femra (54 %). Të dhënat janë mbledhur me një pyetësor të vetadministrueshëm, si instrumenti i vlerësimit të njohurive të popullatës për shëndetin. Studimet kanë treguar nivelin e lartë të njohurive të popullatës lidhur me faktorët e rrezikut për shëndetin por edhe mungesën e vetkujdesit në periudhat kur qytetari gëzon shëndet të plotë. Punimi përfshin 50 faqe, 20 tabela, 23 grafikone dhe 4 figura.

Fjalët kyçe: **njohuritë, shëndeti, sëmundja, faktorët, Gjakovë.**

DEKLARATË STUDENTORE

Si studente e Universitetit të Gjakovës " Fehmi Agani " Fakultetit të Mjekësisë deklaroj se kjo Temë e Diplomës është punim i imi origjinal.

E gjithë literatura dhe burimet e përdorura janë të listuara në referenca dhe plotësisht të cituara.

Falënderimet

Falënderoj familjen time për mbështetjen që më kanë ofruar gjatë këtyre viteve të studimit.

Falënderoj stafin akademik të cilët kanë punuar me neve deri në përfundimin e studimeve.

Po ashtu, një falënderim i veçantë është për mentorin Prof. Ass. Haxhi Kamberi i cili çdoherë ka qenë i gatshëm për të më ndihmuar në realizimin e kësaj teme, si dhe e falënderoj për durimin dhe korrektësinë gjatë realizimit të kësaj teme.

Përmbajtja

1. Abstrakti.....	3
2 Hyrja.....	7
3. Qëllimi dhe objektivat.....	7
4. Metodologjia.....	7
5. Pyetja hulumtuese.....	7
6. Hipotezat.....	7
Kapitulli 1.....	8
1.1 Përkufizimi i shëndetit	8
1.2 Shëndeti si koncept "tërësor".....	9
1.3 Shëndeti Familjar.....	9
1.4 Prodhimi i shëndetit të mirë.....	10
Kapitulli II.....	11
2.1 Shëndeti në komunitet.....	11
2.2 Shëndeti, kuptimi dhe etiologjia.....	11
2.3 Përcaktuesit e shëndetit.....	12
2.4 Përcatuesit psikosocialë dhe mjedisor të shëndetit.....	13
2.5 Kufizimet, pengesat kulturore.....	14
2.6 Parandalimi parësor dhe dytësor.....	14
2.7 Përkufizimi i popullatës në risk.....	15
2.8 Mjekimi në masë.....	16
2.9 Ç'është të këshilluarit në përkujdesjen shëndetësore.....	17
2.10 Shpresa, shërimi dhe shëndeti.....	18
Kapitulli III.....	19
3.1 Ndryshimi i sjelljes.....	19
3.2 Të ushqyerit.....	19
3.3 Vlerësimi i të ushqyerit.....	20
3.4 Ndryshimi i mjedisit.....	20
3.5 Ndikimet psikosociale në shëndet.....	21
3.6 Stresi dhe shëndeti në familje.....	21
Kapitulli IV.....	22
4.1 Rezultate.....	22
4.2 Konkluzione.....	42
4.3 Përfundime.....	44
4.4 Rekomandime.....	45
4.5 Rezyme.....	46
4.6 Referencat.....	47
Biografi e shkurtër e kandidatës.....	48
Shtojca.....	49

Hyrja

Shëndeti është gjendje e mirëqenies së individëve, i cili kërkon vetdijësimin e popullatës në lidhje me shëndetin dhe për faktorët të cilët ndikojnë negativisht në gjendjen shëndetësore të tyre. Në vetdijësimin e popullatës për shëndetin rol të rëndësishëm kanë punonjësit shëndetësorë. Përmes këtij punimi, lexuesit mund të informohen për shëndetin, për mënyrën se si të parandalohet sëmundja dhe të njihen më shumë me faktorët që rrezikojnë shëndetin.

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i punimit të kësaj teme qëndron në marrjen e informacioneve në lidhje me njohuritë e popullatës me shëndetin dhe me njohjen e faktorëve të cilët ndikojnë në shëndet duke përfshirë :

1. Promovimin shëndetësor
2. Edukimin shëndetësor
3. Parandalimin e sëmundjeve
4. Mjekimin e sëmundjes.

Metodologjia

Për punimin e kësaj teme është përdorur metoda e hulumtimit. Përmes kësaj metode me anë të pyetsorëve (anketimit) janë nxjerr rezultatet që tregojnë se sa popullata janë të njohuar për shëndetin dhe për faktorët që ndikojnë në shëndetin e tyre.

Në hulumtim janë përfshirë gjithsej 200 persona të moshave të ndryshme dhe nga vendbanimi urban dhe rural. Hulumtimi është bërë në vitin 2016 dhe ka zgjatur dy muaj (tetor dhe nëntor).

Pyetja hulumtuese- Sa janë të informuar popullata për shëndetin dhe për faktorët që ndikojnë në shëndet?

Hipoteza 0- Njohja e popullatës me shëndetin dhe faktorët që ndikojnë në shëndet është e kënaqshme.

Hipoteza 1- Njohja e popullatës me shëndetin dhe faktorët që ndikojnë në shëndet është e pakënaqshme.

Kapitulli I

1.1 Përkufizimi i Shëndetit

Sipas përkufizimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, shëndeti është : "Gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo thjeshtë mungesa e sëmundjes apo e paaftësisë fizike të organizmit".

Siç shihet, përkufizimi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë përfshin jo vetëm sferën e mirëqenies fizike, por edhe atë mendore dhe shoqërore. Kjo do të thotë se, sipas këtij koncepti, vështirë se mund të gjenden në popullatë individë plotësisht të shëndetshëm.

Nga ana tjetër, edhe nëse për një moment pranohet se një gjendje e tillë ideale (d.m.th. mirëqenie e plotë fizike, mendore dhe shoqërore) ekziston, atëherë në më të mirën e rasteve kjo gjendje do t'i referohej thujse ekskluzivisht subjekteve 20-30 vjeçarë të privuar nga çdo sëmundje, në kulmin e energjive dhe të aktivitetit të tyre fizik, si dhe me kushte të kënaqshme socio-ekonomike.

Enciklopedia mosby medical¹ (1992, faqe 360) e definon SHËNDETIN si “ një formë e mirëqenies fizike, mentale dhe sociale dhe mungesa e sëmundjes ose kushteve të tjera abnormale“.

Për shembull, zhvlerësimi i shëndetit tek një person me diagnosë të shtypjes së lartë të gjakut, ka gjasa që të ndodhë nga sasia e kujdesit mjekësor që është shpenzuar (a është ky person jashtë kujdesit), faktorët e mjedisit (a ka ai person një punë stresuese), dhe stili i jetesës (a pinë duhan ai person ose a ka probleme me peshën).

Të gjithë këta faktorë bashkëveprojnë për të caktuar origjinën e shëndoshë të personit në çfarë do kohe për gjatë ecjes nga e cila ajo zhvlerësohet.

Sa i përket njësisë së matjes, shëndeti varet aq shumë nga kuantiteti i jetës, po aq sa edhe nga kualiteti i jetës.

¹ Rexford E. Santerre, Stephen P. Neun : "Ekonomia shëndetësore " Tabernakul 2014. Cap.2., fq 24.

1.2 Shëndeti si koncept "tërësor"

Shëndeti konsiderohet si koncept "tërësor" duke ju referuar shumë elementeve si:

- "tërësisë së individëve" të një shoqërie,
- "tërësisë së komuniteteve",
- "tërësisë së dimensioneve të shëndetit",apo
- "tërësisë së faktorëve përcaktues të shëndetit".

Kështu,sipas këtij koncepti, "trupi", "mendja", "shpirti" dhe "emocionet" ndërveprojnë dhe funksionojnë si "një e tërë".

Shëndeti si çdo e mirë tjetër e qëndrueshme,prodhon ecuri shërbimesh.Ato shërbime prodhojnë satisfakcion,ose siç e quajnë ekonomistët DOBI.Normalisht,çdo individ zgjedh të konsumoj atë kombinim të të mirave dhe shërbimeve,duke përfshirë shërbimet që prodhohen nga inventori i shëndetit,që siguron më tepër dobi.²

1.3Shëndeti Familjar

Familja luan një rol thelbësor në gjitha aspektet e shëndetit,sëmundjes dhe kujdesit mjekësor.Anëtarët e familjes mund të veprojnë si informatorë,klientë për trajtim,konsultues,ose si pjesë e problemit në kujdesin shëndetësor.

Pavarësisht prej ndryshimeve të shpejta sociale në strukturën dhe funksionin e familjes, familja ngelet njësia më e rëndësishme e marrëdhënieve njerëzore në shoqëri dhe u siguron individëve nevojat e tyre më themelore për siguri fizike dhe emocionale, shëndetin si dhe mirëqenien.Ne e përkufizojmë familjen si "ai grup njerëzish të lidhur biologjikisht,emocionalisht ose ligjërish". Konteksti i rëndësishëm i familjes mund të përfshijë anëtarët e familjes, të cilët jetojnë në distancë me pacientin.

Roli i familjes paraqitet si një burim i rëndësishëm i stresit, mbështetjes sociale, zakoneve të shëndetit si dhe sjelljeve që lidhen me shëndetin. Pjesëtarët e familjes shihen edhe si kujdestarët parësor në sëmundjet parësore.³

² Rextford E. Santerre, Stephen P. Neun : "Ekonomia Shëndetësore" 2014. Cap 2, fq. 26-27

³ John Noble : "Traktati i Mjekësisë së Kujdesit Parësor"2013. Cap.6, fq.54-55

1.4 Prodhimi i shëndetit të mirë

Ekonomistët shëndetësor mendojnë që krijimi dhe mirëmbajtja e shëndetit përfshin një proces prodhues. Sikur që një firmë tregtare që përdor sasi informacionesh të ndryshme, siç është kapitali dhe puna, që të prodhoj ndonjë produkt, një individ përdor informacione të ndryshme mjekësore dhe faktorët tjerë, siç është stili i jetës që të prodhoj shëndet.

Relacioni në mes sasisë së informacioneve dhe prodhimit mund të shfaqet në atë që ekonomistët e quajnë funksion prodhimi.

Një prodhim shëndetësor gjeneralisht rrjedh shkurt për një individ dhe merr formën vijuese:

$$\text{Shëndeti} = H(\text{kujdesi mjekësor, teknologjia, profili, mënyra e jetesës, statusi socioekonomik, ambienti}).$$

Ku shëndeti pasqyron nivelin e shëndetit në një kohë të caktuar:

"kujdesi mjekësor" barazohet me kuantitetin e mbrojtjes mjekësore që konsumohet;

"teknologjia" tregon gjendjen e teknologjisë mjekësore në kohë të caktuar;

"profili" zë gjendjen mentale dhe fizike të individit në një kohë të caktuar;

"stili jetësor" paraqet grupin e ndryshimeve të stilit jetësor siç janë dieta dhe ushtrimet;

"gjendja socio-ekonomike" pasqyron efektin e përbashkët të faktorëve social dhe ekonomik siç është edukimi, të ardhurat dhe varfëria;

"ambienti" që simbolizon faktorët e ndryshëm të ambientit, ku përfshin ajrin dhe cilësinë e ujit.⁴

⁴ John Noble: "Traktati i Mjekësisë së Kujdesit Parësor" 2013. Cap. 6, fq. 54-55

KAPITULLI 2

2.1 Shëndeti në komunitet

Pavarësisht prej ndryshimit të sistemeve të dhënies së kujdesit shëndetësor, çështja kryesore që udhëheq praktikën tona mjekësore vazhdon të jetë "Si ja sigurojmë kujdesin më të mirë të gjithë pacientëve tanë".

Komuniteti i shëndetshëm mund të jetë ai, në të cilin pjesëtarët ndërveprojnë dhe bashkëveprojnë duke ndihmuar njëri-tjetrin për të mësuar dhe për t'ia dal mbanë. Mjedisi fizik mund të jetë jo toksik; statistikën e shëndetit dhe gjendjet ekonomike mund të jenë të favorshme për të gjithë pjesëtarët e komunitetit. Një komunitet i tillë mund të konsiderohet një vend i dëshirueshëm për të jetuar. Mjekët mund të luajnë rol të rëndësishëm drejtues në përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies së komunitetit dhe të pjesëtarëve të tij.

Më tepër se një interes i momentit, mjekësia në komunitet çon në një shëndet më të mirë për pacientin. Metodën filozofike dhe të sistemeve të mjekësisë në komunitet ofrojnë ide për shëndetin publik dhe për metodat praktike për përmirësimin e kujdesit shëndetësor në komunitet të praktikës klinike.⁵

2.2 Shëndeti: kuptimi dhe etiologjia

Promovimi shëndetësor është një koncept kontradiktore dhe ka domethënie të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Ka gjithmonë të dhëna që mbështesin idenë se jetëgjatësia e pritshme mund të ndikohet nga një sërë vetish "pozitive" individuale dhe sociale.

Njerëzit do të jenë më të shëndetshëm nëse ndiejnë se kanë kontroll mbi jetën e tyre dhe se jeta e tyre ka kuptim dhe pasuri emocionale. Me fjalë të tjera, kanë "një sens koherence".

Shqetësimi kryesor i promovimit të shëndetit nuk duhet të jetë vetëm të shtojë vitet e jetës, por të shtojë jetë viteve.

⁵ John Noble: "Traktati i Mjekësisë së Kujdesit Parësor" 2013. Cap. 10, fq. 99

2.3 Përcaktuesit e shëndetit

Pavarësisht nëse shëndeti përkufizohet si mungesa e sëmundjes apo si një gjendje më e gjerë dhe holistike, ka një marrëveshje të përgjithshme për ekzistencën e katër faktorëve madhorë që përcaktojnë se cilët individ janë të shëndoshë dhe cilët jo.




Fig 1. Përcaktuesit e shëndetit. Burimi : Libri "Traktati i Oxfordit për mjekësinë"

Zakonisht, mënyra e jetesës së individit ka qenë shënjestra kryesore e edukimit shëndetësor, bashkë me nxitjen për të përdorur siç duhet shërbimet mjekësore. Pikëpamja aktuale është se, mjedisi në të cilin jetojmë dhe punojmë, ka ndikimin më të madh, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose me ndërmjetësinë e sjelljes së individit. Në përputhje me këtë, strategjitë më efektive të promovimit të shëndetit janë ato që modifikojnë mjedisin, duke e bërë atë më të sigurt dhe më të favorshëm për shëndetin dhe mbi të gjitha, ato përqendrohen mbi faktorët socialë dhe ekonomikë që shkaktojnë pabarazi të shëndetit. Ndryshimi i mjedisit shpesh kërkon ndryshime thelbësore të politikave publike dhe veprime politike shoqëruese. Prandaj, promovimi shëndetësor konsiderohet se përfshin si edukimin mbi shëndetin, ashtu edhe "politika të shëndetshme publike".⁶

⁶ David A. Warrell, Timothy M. Cox, John D. Firth: "Traktati i Oxfordit për Mjekësinë" 2013. Vëllimi 1. Cap 3, fq. 65

2.4 Përcaktuesit psikosocialë dhe mjedisor të shëndetit

Përmes kësaj figure përmblihen faktorët më të rëndësishëm që përcaktojnë nëse individët do të përvetësojnë apo jo një mënyrë jetese të re dhe më të shëndetshme.




Fig 2.Përcaktuesit e veprimeve që lidhen me shëndetin

Burimi: Libri "Traktati i Oxfordit për mjekësin", Vëllimi 1

2.5 Kufizimet dhe pengesat kulturore

Shumë masa parandaluese, synojnë të ndryshojnë sjelljet e dëmshme dhe shumica e sjelljeve kanë një përbërës të fortë socio-kulturor dhe pasqyrojnë qëndrimet mbizotëruese dhe normat e shoqërisë.

Masat parandaluese kufizohen shumë nga ky kontekst social. Bindja e individëve për të lënë duhanin, për të konsumuar më pak kripë, për të pirë më pak alkool ose marrja me aktivitete fizike është e vështirë të gjithë bëjnë të kundërtën. Edhe në rrethanat e një prove klinike, këshillat dietike nga profesionistët e shëndetit në komunitet rrallë arrijnë uljen e nivelit të kolesterolit më shumë se 3 deri 5 %.

Studimet e kufizimit të kripës (për të ulur presionin e gjakut) japin rezultate të ngjashme që një pacient të arrijë një ulje fiziologjike të rëndësishme të konsumit të kripës. Janë të nevojshme edhe ndërhyrje intensive dhe mbështetje dhe shumë prej tyre e konsiderojnë të pahijshme këtë dietë.

2.6 Parandalimi parësor dhe dytësor

Ndërhyrjet parandaluese zakonisht janë klasifikuar si parësore, dytësore dhe terciare. Parandalimi parësor, dytësor dhe terciar mund të përkufizohen kështu :

- **Parandalimi parësor** – ndërhyrjet që synojnë të ulin riskun për sëmundje tek individët e shëndetshëm (p.sh., kontrolli i duhanit për të parandaluar shfaqjen e sëmundjeve të lidhura me pirjen e tij; imunizimi ndaj sëmundjeve infektive).
- **Parandalimi dytësor** – ndërhyrjet që synojnë të parandalojnë sëmundshmërinë, e cila mund të shmanget tek individët e sëmurë (p.sh., trajtimi i sëmundjes vaskulare me aspirinë, depistimi për kancerin në stadi të hershëm).
- **Parandalimi terciar**- është kujdesi, që lidhet drejtëpërdrejtë me parandalimin e komplikacioneve ose sëmundshmërinë e tepërt të individët me sëmundje të përcaktuar kronike simptomatike.⁷

⁷ David A. Warrell, Timothy M. Cox, John D. Firth: "Traktati i Oxfordit për Mjekësinë" 2013. Vëllimi 1. Cap 3, fq. 67

Është e kuptueshme që dallimi ndërmjet parandalimit parësor dhe atij dytësor është i vështirë. Disa ndërhyrje mund të bëjnë pjesë në më shumë se një kategori (p.sh., ndalimi i duhanit ngadalëson përparimin, si dhe fillimin e shumë sëmundjeve të lidhura me duhanin) dhe përkufizimi i sëmundjes nuk është absolut (p.sh., shumë individ në dukje të shëndetshëm, kanë sëmundje të pazbuluara).

Disa nga tendencat më të rëndësishme që në vendet e industrializuara e kanë transformuar shëndetin publik dhe mjekësinë parandaluese :

- Përfshirja në rritje e praktikave administrative dhe të biznesit në shërbimet e shëndetit publik e parandalues si edhe në përhapjen e shërbimit të shëndetit publik.
- Ndryshimet në përcaktimin e grupit apo popullatës, njësi bazë e shëndetit publik.
- Përmirësimi i konceptimit dhe matja e gjendjes shëndetësore personale.
- Rritja e kodifikimit dhe interpretimit të të dhënave shkencore të rëndësishmetë lidhura me parandalimin dhe shëndetin publik.
- Përcaktimi i synimeve shoqërore, për të përfituar përmirësime në gjendjen shëndetësore.
- Aplikimi i sistemeve më të përparuara të informimit të komunitetit shëndetësor.

2.7 Përkufizimi i popullatës në risk

Meqenëse mjekësia parandaluese synon që në të ardhmen të pakësoj sëmundjet, pacientët zakonisht identifikohen nga karakteristikat që parashikojnë riskun për tu sëmurë. Në shumicën e rasteve , risku përkufizohet në tri mënyra:

- ❖ Demografik
- ❖ Fenotipik dhe
- ❖ Familjar.⁸

⁸ David A. Warrell, Timothy M. Cox, John D. Firth: "Traktati i Oxfordit për Mjekësinë" 2013. Vëllimi 1. Cap 3, fq. 68

Risku demografik- Është mënyra më e zakonshme për të përkufizuar grupin që do të jetë shënjestër për mjekësinë parandaluese (p.sh., klasifikimi i ndërhyrjeve parandaluese sipas moshës së popullsisë, ose programet depistuese, të cilat shpeshkanë në vëmendje sëmundje specifike sipas gjinisë p.sh. kanceri i gjirit). Përcaktimi gjeografik i riskut ka prirjen të pasqyrojë kufijtë e sistemit të kujdesit shëndetësor.

Risku fenotipik- Fenotipi është një grup karakteristikash të dukshme të një individi ose grupi. Pjesa më e madhe e faktorëve të riskut epidemiologjik për sëmundje (p.sh., pirja e duhanit, obeziteti, hiperlipidemia) janë fenotipikë. Kategori të tjera fenotipike të përdorura për të përcaktuar popullatat në risk janë sjelljet (p.sh., pirja e duhanit), sëmundjet kronike (p.sh., diabeti, angina) dhe karakteristikat fizike (p.sh., obeziteti, niveli i kolesterolit).

Risku familjar- Pjesa më e madhe e programeve të mjekësisë parandaluese në këtë fushë përdorin vlerësimin gjenetik për të përmirësuar vlerësimin e riskut të individit në familje me risk të lartë (p.sh., fibroza cistike, neurofibromatoza) apo në popullatë me risk të lartë (p.sh., sindroma Down), të identifikuar fenotipikisht.

2.8 Mjekimi në masë

Llogaritjet rrezik-përfitim janë të nevojshme për të gjitha format e mjekimit në masë, jo vetëm për imunizimet.

Kundërshtimi për fluorizimin e ujit të pijshëm bazohet në frikën nga kanceri ose nga ndonjë sëmundje tjetër. Studimet epidemiologjike kanë treguar se nuk ka lidhje mes fluorizimit dhe kancerit.

Njerëzit në një shoqëri të lirë duhet të jenë në gjendje të zgjedhin për veten e tyre nëse duan të pinë ujë të fluorizuar.

Disa njerëz kundërshtojnë në mënyrë të ndërgjegjshme mjekimin në masë, siç është fluorizimi i ujit të pijshëm ose imunizimi i fëmijëve kundër sëmundjeve ngjitëse.⁹

⁹ Robert B. Wallace, Neal Kohatsu, John M. Last : "Shëndeti Publik & Mjekësi Parandaluese "2014. Cap.3, fq.30

2.9 Ç'është të këshilluarit në përkujdesjen shëndetësore ?

Të këshilluarit është një proces i fillimit të ndryshimit drejt të jetuarit të shëndetshëm dhe shërimit, ku njerëzit (individë, grupe, çifte dhe familje) ndihmohen që :

- Të shprehin vetveten në një klimë të sigurt, mbështetëse, bashkëpunues-gjykyese
- Të veçojnë dhe qartësojnë problemet e tyre dhe të thellojnë vetëdijen mbi të shkuarit dhe të tashmen
- Të dallojnë mënyrat e papërshtatshme dhe të padobishme të veprimit
- Të përshtatin, aty ku të jetë e mundur, shprehi më të dobishme veprimi
- Të dallojnë dhe të arrijnë qëllimet e rëndësishme për ta.¹⁰

Të këshilluarit është një marrëdhënie, në të cilën një njeri ndihmon për të kuptuar më mirë dhe për të zgjidhur problemet. Këshilluesit kanë një përvojë të gjatë në zhvillimin e "metodave ndihmëse" dhe në punën në shumë situata të ndryshme.



Foto 1. Komunikimi mjek-pacient

Burimi: www.google.com

¹⁰ K.R.Sethuraman : "Shprehitë e komunikimit në praktikën klinike" (Komunikimi mjek-pacient)
Tabernakul 2014. Cap. 2, fq 85-86.

2.10 Shpresa, shërimi dhe shëndeti

Shpresa shoqërohet pozitivisht nga shërimi dhe shëndeti. Vëzhgimet empirike, të cilat pa dyshim përbëjnë fakte të dobëta, kanë vënë në dukje potencialin terapeutik të shpresës. Këto sugjerojnë që shpresa:

- Mund të ndihmojë shërimin,
- Mund të lehtësojë procesin e trajtimit,
- Mund të rrisë cilësinë e jetës.¹¹

Mjekët profesionistë mund ta perceptojnë ngjalljen e shpresës si të ngjashme me fjalët lehtësuese dhe për këtë arsye të ngurojnë dhe të mos e përdorin këtë taktikë kur flasin me pacientë.

Megjithatë, duhet kuptuar se, përballë paqartësisë, shpresa nuk është e gabuar. Shpresa është gjendje psikologjike dhe nuk ka të bëjë me statistikën biologjike.

Shpresa mund të konceptualizohet në tri përmasa :

- Vetjake
- Situacionale dhe
- Ndërpersonale.

Por së pari duhet të zbatohet modeli i përgjithshëm i zgjidhjes së problemeve:

identifikimi i problemeve, identifikimi i mundësive dhe vendosja se cilat probleme janë më prioritare, persona të veçantë, komunitete, punonjës të kujdesit shëndetësor e kështu me radhë. Të mblidhet i gjithë informacioni i mundshëm dhe të vlerësohet me kujdes që të vendosen prioritetet.

¹¹ K.R.Sethuraman : "Shprehite e komunikimit në praktikën klinike "Cap.2,fq.85 dhe Cap.2 fq.126

Kapitulli III

3.1 Ndryshimi i sjelljes

Faktorët mjedisorë luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë së parakohshme. Shumë prej këtyre faktorëve mjedisorë pasqyrojnë sjelljen individuale. Ushqimi më i shëndetshëm, aktiviteti fizik, janë mënyra të parandalimit të sëmundjeve.

Njerëzit i dëgjojnë mjekët dhe një sërë provash klinike kanë treguar se këshillat mbi modifikimin e sjelljes janë kosto-efektive, edhe pse efekti mund të jetë i vogël (p.sh., në shumicën e studimeve vetëm 1 në 20 deri në 30 duhanpirës që këshillohet ta lërë duhanin, e le me të vërtetë atë).

Këshillat e shkurtra janë më efektive nëse kanë natyrë praktike (udhëzime se si mund të arrihet ndryshimi).

Ndërhyrjet intensive kanë prirjen të jenë më pak kosto-efektive. Koha që kalohet me aktivitetet parandaluese alternative (p.sh., menaxhimi efektiv i sëmundjeve kronike) mund të arrijnë përfitime më të mëdha.

3.2 Të ushqyerit

Synimi i përmirësimit të shëndetit të popullsisë nëpërmjet metodave të tilla si: aktiviteti fizik dhe të ushqyerit, është vendosur në qendër të interesit mjekësor. Popullata dhe ekspertët e shëndetit janë të vetdijësuar për të mirat që vijnë nga ushqyerja e shëndetshme, por megjithatë ka një mungesë të theksuar në marrjen e masave konstruktive.

Përmirësimi i dietës ushqimore, nëpërmjet edukimit të popullsisë, është pjesë e përpjekjeve për të parandaluar shfaqjen e sëmundjeve kronike.¹²

¹²David A. Warell, Timothy M. Cox, John D. Firth: "Traktati i Oxfordit për Mjekësinë" Vëllimi 3. Cap 3, fq. 64

3.3 Vlerësimi i të ushqyerit

Vlerësimi i të ushqyerit është një proces që përcakton nëse sasia e përshtatshme e një lënde të nevojshme ushqyese është e pranishme dhe e përthithur nga trupi. Personat që kanë nevojë për një vlerësim më të zgjeruar janë ata pacientë të cilët janë mbi peshë ose nën peshë, ata që janë të prekur nga një sëmundje e rëndë akute ose kronike, foshnjat dhe fëmijët, personat që jetojnë në varfëri ose nuk kanë mundësi të konsumojnë shumëllojshmëri ushqimesh, shumica e të moshuarve në gjendje të brishtë shëndetësore dhe pacientët të cilët nuk mbajnë një dietë tradicionale, siç janë personat e fiksuar pas dietës për t'u dobësuar.



Foto 2. Ushqime të shëndetshme

Burimi: www.google.com

3.4. Ndryshimi i mjedisit

Faktorët mjedisorë përfshijnë :

- sigurinë e vendit të punës,
- ndotjen mjedimore,
- sigurinë e transportit,
- higjienën ushqimore dhe
- sigurimin e ujit të pastër.

Jo të gjithë pacientët kanë shkaqe alergjike të identifikueshme për simptomat e tyre dhe, edhe nëse identifikohet një shkak i tillë, jo gjithmonë është e mundur shmangia e tij (p.sh., pluhuri i shtëpisë në astmë).

Por mund të bëhen përmirësime të theksuara .¹³

¹³ David A. Warrell, Timothy M. Cox, John D. Firth: "Traktati i Oxfordit për Mjekësinë" 2013. Vëllimi 1. Cap. 3, fq. 60.

3.5 Ndikimet psikosociale në shëndet

Faktorët psikosocial ndikojnë në shëndet. Në kuadrin e punës në sistemet e trupit ndërveprojnë për të prodhuar në mënyrë të njëpasnjëshme sisteme biologjike më komplekse, të cilat janë të ndikuara njëkohësisht nga faktorët shoqërorë dhe psikologjikë.

Organizmi është konceptuar në sisteme komplekse dhe ndërvepruese biologjike, psikologjike dhe shoqërore si dhe as sëmundja e as dobësitë nuk mund të kuptohen nga reduktimi gjithmonë e më i vogël i përbërësve biologjikë.

Për të kuptuar një sëmundje duhet të merren parasysh faktorët ndërveprues të tillë, si ambienti shoqëror dhe kulturor, dhe burimet psikologjike të individëve të prekur.

3.6 Stresi dhe shëndeti në familje

Lidhjet dhe problemet shëndetësore brenda familjeve janë burimi kyç i stresit për individët. Stresi mund t'i referohet secilit prej tre komponenteve të atij që është quajtur procesi i stresit:

- stresuesit
- ngjarjet mjedisore të perceptuara dhe të përjetuara nga një individ
- përgjigja fiziologjike ndaj stresuesve ose pasojat shëndetësore të stresuesve.¹⁴

Metoda më e sukseshme e studimit të stresit dhe shëndetit ka qenë ekzaminimi i stresuesve, sidomos lidhja e ngjarjeve të perceptuara si stresuese në jetë, me sëmundjen. Ngjarjet jetësore që perceptohen negativisht ose që nuk janë nën kontrollin e individit kanë efekt të kundërt në shëndet.

¹⁴ Robert E. Rakel: "Traktati i mjekësisë së familjes " 2013. Cap. 3, fq. 27

Kapitulli IV

4.2.Rezultatet


Të dhënat e përgjithshme të pjesëmarrësve në hulumtim

Tabela1. Ndarja e të anketuarve në bazë të moshës për vitin 2016.

Viti	Mosha							
	(0-18)		(19-65)		(Mbi 65)		Gjithsej	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
2016	29	14.5	131	65.5	40	20	200	100

Në këtë tabelë paraqitet numri i personave të anketuar të paraqitur në bazë të moshës së ndarë në tri grupmosha.Në bazë të këtyre të dhënave vërehet se dominon mosha e mesme (65.5 %) dhe mosha e tretë (20 %) sa i përket marrjes pjesë në hulumtim,ndërsa në numër më të vogël pjesëmarrje janë mosha e re (14.5 %).

Grafiku 1.Ndarja e të anketuarve në bazë të moshës




Tab.2 Ndarja e të anketuarve në bazë të vendbanimit në vitin 2016

Viti	Vendbanimi					
	Urban		Rural		Gjithsej	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%
2016	82	41	118	59	200	100

Në këtë tabelë është paraqitur ndarja e popullatës në bazë të vendbanimit (Urban dhe Rural) për vitin 2016 dhe të dhënat tregojnë se në hulumtim nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 82 nga ta kanë qenë nga vendbanimi urban (41 %), dhe 118 të anketuar kanë qenë nga vendbanimi rural (59 %).

Grafiku 2. Ndarja e të anketuarve në bazë të vendbanimit në vitin 2016




Tab.3 Ndarja e të anketuarve në bazë të gjinisë në vitin 2016

Viti	Gjinia					
	M		F		Gjithsej	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%
2016	92	46	108	54	200	100

